



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË

No. 71 prot
Dt. 12/12/2018

VENDIM

Nr. 6 Datë 11.12.2018

“MIRATIM PËR AUTORIZIM PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR”

Z. Prek KODRA

Në mbështetje të ligjit nr.6/2018 për disa ndryshime dhe shtesa të ligjit nr.111/2012 dt.15.12.2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të nenit 38 “Qëllimet e përdorimit të burimeve ujore” gërma a, dhe të nenit 41 “Përdorimi me leje i ujit” gërma e, të VKM Nr.416 datë 13.05.2015, “Për miratimin e kushteve të përgjithshme dhe të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe leje për përdorim të burimeve ujore”, bazuar në relacionin e paraqitur nga A.B.U. Drin-Bunë dhe miratimin në parim të Këshillit Konsultativ Këshilli i Basenit Ujor Drin-Bunë,

V e n d o s i :

1-Të miratojë kërkesën e **Z. Prek KODRA**, me vendodhje në fshatin Bogë, Njësia Administrative Shkrel, Bashkia Malësi e Madhe, Qarku Shkodër për përdorim të burimit ujor nëntokësor **Qafa e Bunit të Thorës**, për qëllime shtëpiake me këto të dhëna në KRGJSH :

Koordinatat e vepres së marrjës : X – 47 64 94.673 ; Y – 46 94 903.196 ; Z – + 1593 m ;
Kordinatat e Pikës së shkarkimit : X – 47 48 70.673 ; Y – 46 95 799.196 ; Z – + 1176 m ;
Prurja mesatare vjetore e burimit : Qmes = 0.1-0.2 l/sek .
Prurja mesatare e muajit më të thatë : Qmes_{th} = 0.012 l/sek.
Prurja mesatare në kohë ujëshumtë : Qmes_{sh} = 3-4 l/sek .
Sasia e ujit që jepet për përdorim : Qllog = 0.03 l/sek .

2-Ngarkohet A.B.U. Drin- Bunë për zbatimin e këtij vendimi .

PËR KËSHILLIN E BASENIT UJOR DRIN-BUNË

SEKRETAR

Raimonda GURI

KRYETAR

Çesk MILLJA